



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)
Kosovo Investment and Enterprise Support Agency (KIESA)
Agencija za Investicije i Podršku Preduzeča na Kosovu (KIESA)

PËR/ZA/TO:	Endrit Shala, Ministër i Tregtisë dhe Industrisë				
CC:					
PËRMES/PREKO/THROUGH:					
NGA/OD/FROM:	Nol Buzhala, UD, Drejtor i Përgjithshëm i KIESA-s				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti vjetor i KIESA, 2018				
Nr. i zyrës:	1	Lokacioni:	36 541	Data:	14.01.2019
Br. kancelarije:		Kucni:		Datum:	
Room No.:		Extension:		Date:	

RAPORTI VJETOR 2018

AGJENCIA PËR INVESTIME DHE PËRKRAHJEN E NDËRMARRJEVE NË
KOSOVË (KIESA)

Prishtinë, janar 2019

PËRMBAJTJA

KIESA	3
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
DREJTORATI PËR PROMOVIMIN E SEKTORIT PRIVAT	5
PROMOVIMI I INVESTIMEVE	5
PROMOVIMI I EKSPORTIT	11
DREJTORATI PËR ZHVILLIMIN E SEKTORIT PRIVAT	13
NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME	13
ZONAT EKONOMIKE	15

AGJENCIA PËR INVESTIMEVE DHE PËRKRAHJEN E NDËRMARRJEVE NË KOSOVË (KIESA)

Agjencia për Investimeve dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) është agjenci shtetërore e Kosovës mandati i së cilës është të promovojë dhe mbështesë investimet, eksportin, NVM-të, dhe Zonat Ekonomike në Republikën e Kosovës. Është e përbërë nga dy drejtorate, respektivisht nga 4 sektorë; promovimi i investimeve, promovimi i eksportit, zhvillimi i NVM-ve dhe zhvillimi i Zonave ekonomike.

Legjislacioni

- Ligji nr. 04/L-220 për Investimet e Huaja
- Ligji nr. 05/L-079 për Investime Strategjike në Republikën e Kosovës dhe akteve nënligjore të dala nga ky ligj, si:
 - Udhëzimin administrativ nr. 01/2018 për mënyrën e vënies në dispozicion të pasurive të paluajtshme në pronësi të ndërmarrjeve publike për zhvillimin dhe realizimin e projekteve për investime strategjike
 - Udhëzimin administrativ (qrk) nr 02/2018 për mënyrën dhe metodat e verifikimit të përmbushjes së kriterëve për përcaktimin e statusit të investitorit strategjik
 - Rregulloren (qrk) nr. 19/2017 për mënyrën e punës dhe funksionimit të komisionit ndërministror për investimet strategjike
 - Udhëzimin administrativ (qrk) nr. 11/2017 për formën dhe përmbajtjen e regjistrit lidhur me projektet që kanë marr statusin e investimeve strategjike.
- Ligji nr. 04/l-159 për Zonat Ekonomike, dhe akteve nënligjore të dala nga ky ligj, si:
 - Udhëzimin administrativ Nr. 01/2014 (MTI) Për përcaktimin e procedurës së paraqitjes së kërkesës për marrjen e pëlqimit, procedimit të saj dhe dhënien e pëlqimit, mënyrën dhe procedurat për konsultim publik, si dhe përmbajtja e regjistrit të zonave ekonomike.
 - Udhëzimin administrativ Nr. 02/2014 (MTI) Për përmbajtjen e studimit të fizibilitetit.
 - Udhëzimin administrativ Nr. 03/2014 (MTI) Për procedurën, formën dhe përmbajtjen e konkursit, kushtet dhe kriteret për vendosjen e subjekteve afariste brenda hapësirave të zonave Ekonomike,
 - Udhëzimin administrativ Nr.15/2016 (MTI për mënyrën e themelimit, funksionimit dhe administrimit të inkubatorëve të biznesit.
 - Udhëzimin administrativ (QRK) nr. 03/2014 për përcaktimin e kushteve dhe lehtësirave për bizneset që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në kuader të zonave ekonomike
- Udhëzimin administrativ (MTI) nr. 01/2018 për ndarjen e mjeteve financiare nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Promovimi i investimeve

Janë realizuar tri (3) konferenca për investime dhe tregti dhe gjashtë (6) sesione informuese ku janë realizuar takime me 312 biznese të huaja të cilat janë njoftuar për kushtet dhe mundësitë e përgjithshme për investime në Kosovë. Janë përkrahur në mënyrë të drejtpërdrejtë investitor të rinj të huaj të cilët kanë investuar në Kosovë. Janë kontaktuar biznese të huaja të regjistruara pranë ARBK-së dhe janë vizituar një numër i konsiderueshëm prej tyre. Janë realizuar takime me 12 komuna për të bashkërenduar shërbimet ndaj IHD-ve.

Promovimi i Eksportit dhe Turizmit

Është subvencionuar pjesëmarrja e 36 ndërmarrjeve në 10 panairë ndërkombëtare ku janë promovuar 267 produkte kosovare dhe janë nënshkruar 54 kontrata për eksport në gjashtë (8) tregje të reja. Së bashku me projektin i ICEP janë realizuar pesë (5) konferenca sektoriale mbi sfidat dhe objektivat e ndërmarrjeve në këta pesë (5) sektorë ekonomik.

Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme

Është koordinuar raportimi në OECD i të gjitha institucioneve kosovare rreth Aktit Evropian për Biznes të Vogël dhe Perspektivës së Konkurrueshmërisë. Është finalizuar suksesshëm nënshkrimi i marrëveshjes për anëtarësimin e Kosovës në Programin COSME dhe janë ekzekutuar obligimet financiare. Në Ditët e Biznesit të Vogël 2018 janë organizuar shtatë (7) konferenca regjionale dhe janë ndarë 21 mirënjohje për top NMVM-të 2018.. Është organizuar Panairi “Gratë në Biznes” ku kanë marrë pjesë 30 biznese dhe OJQ me pronare femra, si dhe “Panairi i Gjilanit” ku kanë marrur pjesë mbi 100 biznese vendore dhe të huaja. Tek kategoria e subvencionit janë përkrahur gjithsej 35 ndërmarrje me qëllim të blerjes së makinerisë prodhuese si dhe katër (4) ndërmarrje për certifikim të produktit.

Zonat Ekonomike

Gjatë vitit 2018 janë nënshkruar marrëveshjet e bashkëfinancimit me kohëzgjatje prej tri viteve, në vlerë prej 5.5 milion euro për ndërtim të zonave ekonomike në komunën e Vitisë, Suharekës dhe Vushtrrisë. Po ashtu është nënshkruar marrëveshje bashkëfinancimi me komunën e Malishevës për Zonën ekonomike në Malishevë, ku sipas marrëveshjes është përgatitur Studimi i Fizibilitetit. Ndërsa në Parkun e Biznesit në Drenas janë realizuar investime shtesë në rehabilitimin e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit brenda PBD, mirëmbajta e hapësirave të parkut, sigurimi fizik i hapësirave të PBD, si dhe ndërtimi i kanalizimit të impiantit.

1. Drejtorati për Promovim të Sektorit Privat

Drejtorati për Promovim të Sektorit Privat ka për qëllim të zhvilloi dhe mbikëqyrë zbatimin e politikave dhe procedurave standarde dhe ofrimi i shërbimeve me qëllim të promovimit të vazhdueshëm të investimeve, eksportit dhe turizmit. Në kuadër të së cilit bëjnë pjesë dy sektorë:

- 1.1 Sektori për promovim të investimeve dhe
- 1.2 Sektorit për promovim të eksportit dhe turizimit

1.1 Sektori për Promovimin e Investimeve

Sektori për promovimin e investimeve (SPI) ka për detyrë promovimin e kushteve dhe mundësive që ofrohen për investitorë. Në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi të veta, SPI ofron shërbime përkrahëse për investitorë përgjatë tri fazave:

- Fazës para investimeve,
- Fazës gjatë investimeve dhe
- Fazës pas investimeve (After-care).

Po ashtu, Sektori për promovim të investimeve e bënë vlerësimin teknik të projekteve potenciale për investime strategjike, të riskut operacional dhe të planit të veprimit për realizimin e këtij projekti, si dhe analizon profilin e subjektit investues si dhe elemente të tjera të nevojshme për të provuar aftësitë e subjektit aplikues për të qenë investues strategjik.

Faza para investimeve, përfshinë shërbimet që i ofrohen një investitori të huaj para procesit të investimit në Kosovë, duke ofruar shërbimet:

- Ndhmë dhe këshilla si ta filloni një biznes të ri në Kosovë;
- Asistim në procedurat e regjistrimit të biznesit;
- Asistim në aplikim për licenca dhe leje të nevojshme për biznesin tuaj;
- Organizimi i takimeve me institucione lokale dhe qendrore si dhe takime me biznese vendore dhe të huaja;
- Ndhmë për identifikimin e vendit ideal për të lokalizuar biznesin tuaj.

Faza gjatë investimeve, përfshinë shërbimet që iu ofrohen investitorëve gjatë procesit të investimit në kuadër të të cilit kompanisë së huaj i ofrohen shërbimet:

- Ndhmë për të gjetur patundshmëri që të akomodoj biznesin e tij;
- Ndhmë në aplikimin dhe vendosjen nëpër zona industriale dhe inkubator biznesi;
- Sigurimi i informatave për sektor specifik, projekte të ndryshme dhe partnerë të mundshëm, me të cilët mund të bashkëpunoj;

Faza pas investimeve (After-care), përfshinë shërbimet pas përmbylljes së projektit investiv duke ofruar shërbimet:

- Asistencë në organizimin e takimeve B2B dhe pjesëmarrje në konferenca;

- Njoftim mbi ndryshimet e reja në ligje, sistemin tatimor, dhe informata të tjera relevante.

Investimet Strategjike, me qëllim të implemtimit të legjislacionit për investime strategjike, janë organizuar:

- Takime direkte me investitorët potencial strategjik,
- Konferenca të ndryshme,
- Promovim të projekteve strategjike në bashkëpunim me palët e interesit.

Faza para investuese, mbështetja e investitorëve të huaj në Kosovë


Në kuadër të shërbimit ndaj investitorëve të huaj, gjatë këtij viti janë realizuar takime dhe janë siguruar informata për 132 biznese, të cilat janë njoftuar për kushtet dhe mundësitë e përgjithshme për investime. Po ashtu, janë njoftuar për përkrahjen që ofron Agjencia për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve (KIESA) për investitorët e huaj.

Janë takuar 200 biznese të huaja nëpër evente të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, të cilat janë njoftuar për kushtet dhe mundësitë e përgjithshme për investime në Kosovë.

Janë realizuar takime me përfaqësitë diplomatike në Kosovë (Finlanda, Italia, Gjermania, Anglia, Kroacia, Greqia dhe Franca), koordinimin në lidhje me aktivitetet që kanë për qëllim investimet e huaja dhe mbështetjet ndaj investitorëve aktual dhe atyre që kanë për synim investimet në Kosovë.

Investimet e huaja direkte (IHD)

Agjencia për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve, sa i përket të dhënave për Investimet e Huaja Direkte në Kosovë bazohet në raportet e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), të cilat publikohen në faza periodike. Andaj, bazuar në të dhënat e BQK-së, shtetet që kanë investuar më së shumti janë: Zvicra, Gjermania, Britania e Madhe, Shqipëria dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ndërsa, sektorët ku është investuar janë: Patundshmëria, Qiradhënia dhe aktivitetet biznesore, Shërbimet Financiare, Ndërtimi, Industria etj.

Figura 2. Investimet sipas viteve, periudha 2007- shtator 2018**Figura 3.** Investimet sipas shteteve, periudha 2007- shtator 2018

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

Konferencat dhe Sesionet informuese për Promovim të Investimeve

Qëllimi i realizimit të konferencave për promovim të investimeve është informimi dhe tërheqja e investitorëve nga vendet e ndryshme për të investuar në Kosovë. Brenda vitit 2018 janë realizuar këto aktivitete:

- Sesione Informuese, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme (MPJ), Ministrinë e Diasporës dhe Investimeve Strategjike (MeD&IS), Ministrinë e Financave (ATK dhe DK) dhe Rrjetin e Bizneseve të Diasporës, janë organizuar gjashtë (6) sesione informues në këto vende: Suedi, Gjermani, Turqi, Zvicër, Francë dhe Itali me bizneset e diasporë shqiptare, në të cilat kanë marrë pjesë mbi 180 sipërmarrës nga diaspora.
- Konferenca për investime të organizuara në bashkëpunim me institucionet partnere janë organizuar pesë (5) të tilla, që kanë pas për qëllim promovimin e investimeve dhe

potenciale investive në Kosovë. Konferencat janë mbajtur në këto vende: Austri, Bullgari, Itali, Shqipëri dhe Kosovë.

- Simpozium në bashkëpunim me GIZ dhe Ministrinë e Ndërmarrësisë, ku janë promovuar 15 biznese kosovare të sektorit të IT-se dhe prodhimitarisë.
- Pjesëmarrja në simpoziumin e 53 të BME 2018 e organizuar në bashkëpunim me GIZ, Ministrinë e Inovacionit dhe OEGJK. Ku ju është dhënë mundësia 15 ndërmarrjeve kosovare që të marrin pjesë në këtë simpozium tre ditor.
- Pjesëmarrja në takimet e RCC dhe RIRA dhe takimet e iniciativave të bashkimit ekonomik regjional, në bashkëpunim me institucione të ndryshme për qëllim promovimin dhe tërheqjen e investimeve.
- Në kuadër të bashkëpunimit rajonal, kemi marrë pjesë në forumin e vendeve të Ballkanit Perëndimor, lidhur me modelet e diplomacisë ekonomike, mbajtur në Sarajevë-BIH.
- Pjesëmarrja në takimin rajonal, lidhur me shkëmbimet e politikave të reja të investimeve dhe marrëveshjet bilaterale për mbrojtje dhe promovim të investimeve, mbajtur në Tiranë-Shqipëri.
- Pjesëmarrja në takimin për promovimin e investimeve të huaja direkte në Industrinë nxjerrëse në Kosovë me mbështetje të departamentit amerikan të tregtisë, mbajtur në Prishtinë.
- Pjesëmarrja në takimet ndërinstitucionale, lidhur me krijimin e mekanizmave lokal për promovimin e investimeve nga diaspora, me mbështetje nga zyra e Komisionit Evropian në Kosovë. Projekti është zbatuar nga Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike (MeD&IS).
- Pjesëmarrja në takimin shumëpalësh për mundësitë e përfitimit të komunave të regjioneve (Ferizaj, Gjakovë, Prizren dhe Pejë), nga sistemi Italian në Kosovë, organizuar nga Ambasada Italiane ,Agjencia Italiane për Zhvillim dhe Agjencia Italiane për Tregti me mbështetje nga KFOR-i Italian në Pejë.

INVESTIMET STRATEGJIKE

Gjatë kësaj periudhe ka filluar implementimi i Ligjit për Investime Strategjike.

Në kuadër të zbatimit të Ligjit Nr. 05/L -079 për Investime strategjike në Republikën e Kosovës dhe akteve nënligjore, gjatë këtij viti janë pranuar njëmbëdhjetë (11) aplikacione nga subjekte aplikuese për përfitim të statusit të investimit strategjik. Prej të cilave një (1) subjekt aplikues ka arritur të kompletoj dosjen e aplikimit, sa i përket procedurave administrative. Lënda është përcjellë tek institucionet relevante, në pajtim me Udhëzimin Administrativ(QRK) Nr. 02/2018 për Mënyrën dhe Metodën e Verifikimit të Përbushjes së Kriterëve për Përcaktimin e Statusit të Investitorit Strategjik.

Subjektet aplikuese kryesisht i përkasin sektorit ‘Energji me infrastrukturë dhe miniera’.

Tabela e aplikueseve më sektorë :

Sektori i investimit	Nr. i aplikacioneve
Energji me infrastrukturë dhe miniera	9
Transport dhe telekomunikacion	1

Turizëm	1
Industri përpunuese	-
Bujqësi dhe industri ushqimore	-
Shëndetësi;	-
Parqe industriale dhe teknologjike	-
Administrim i ujërave të zeza dhe mbeturinave	-

Faza gjatë investimit - mbështetja e Investitorëve të huaj në Kosovë

Në kuadër të shërbimit gjatë procesit të investimit KIESA gjatë këtij viti ka përcjellë nga afër kompanitë (investitorë të huaj) të cilave iu janë ofruar shërbimet e nevojshme në procesin e lehtësimit të operimit të tyre në vendin tonë.

Janë përcjellë nga afër investitorë të huaj të cilët janë duke investuar ose duke bërë hulumtime/analiza për investime në vendin tonë:

- Teleperformance
- Bunsam Metal Sh.P.K.
- Levin Sh.P.K.
- SOUTHERLAND Global Services Kosovo
- BE Assured Sh.P.K,
- Hydroline Sh.P.k
- " Onix SPA" L.L.C.

Janë kontaktuar dyqind (210) kompani të huaja dhe janë vizituar tridhjetë (30) kompani të huaja, të cilat janë dëgjuar rreth mjedisit të të bërit biznes dhe klimës së investimeve në Kosovë.

Faza e kujdesit të më pastajmë – mbështetja ndaj investitorëve

Për të avancuar edhe me tutje dialogun ndërmjet bizneseve dhe qeverisë Agjencia për Investime dhe Përkrahje të ndërmarrjeve në Kosovë ka realizuar programin e përkujdesit të më pastajmë për biznese. Gjatë kësaj faze janë realizuar vizita në 35 biznese të profileve dhe sektorëve të ndryshëm.

Gjatë komunikimit me këto biznese, bizneset janë njoftuar mbi rolin që ka KIESA dhe shërbimet përkrahëse që iu ofrohen bizneseve. Për të nxjerrë të dhëna sa më të frytshme në kuadër të këtij procesi, SPI ka hartuar pyetësor për të marrë opinionin nga bizneset në funksion të përmirësimit të mjedisit të të bërit biznes dhe klimës investive në vend.

Nga kontaktet e realizuara, përkatësisht komunikimi me biznese rezulton se investitorët e huaj aktual ndajnë përshtypjet të ndryshme por edhe të ngjashme sa i përket mjedisit të të bërit biznes dhe klimës së investimeve në Kosovë.

Gjetjet e nxjerra tregojnë për nevojën e përmirësimeve të më tejshme në aspekte të caktuara që kanë të bëjnë me zhvillimin e biznesit.

Vlen të veçohen:

- Thjeshtimi i mëtotjeshëm i procedurave burokratike
- Efikasiteti i administratës publike, si në nivel qendrorë ashtu edhe në atë lokal,
- Partneritet më i ngushtë ndërmjet institucioneve dhe komunitetit të biznesit
- Çështja e stimujve (fiskal dhe financiar)
- Interesim për funksionalizmin e Ligjit për Investime Strategjike, respektivisht mundësitë e përfitimit nga ky ligj.

Marrëveshjet për mbrojtje dhe promovim reciprok të Investimeve

Në kuadër të përmirësimit të klimës investive dhe me qëllim tërheqjen e investimeve nga vendet e ndryshme, Kosova ka nënshkruar dhe/apo është në fazë negociuese nënshkrimin e marrëveshjeve dypalëshe me këto vende:

- Marrëveshja për Mbrojtje dhe Promovim reciprok të investimeve me qeverinë e Hungarisë, është në fazë negociuese.
- Marrëveshja për Mbrojtje dhe Promovim reciprok të investimeve me qeverinë kanadeze është nënshkruar.
- Marrëveshja Kuvajti është në proces negociimi
- Marrëveshja me Malin e zi është në proces negociimi
- Marrëveshja me Kroacisë është në proces negociimi
- Marrëveshja e COSME
- Marrëveshja EEBEDIF

1.2 Sektori për promovimin e eksportit

Sektori për promovimin e eksporteve ka për qëllim krijimin e parakushteve dhe ndihmesën për kompanitë eksportuese në plasimin e produkteve jashtë vendit. Ofrimin e informatave mbi kushtet e eksporteve në tregjet e jashtme, ndihmën logjistike gjatë përzgjedhjes së tregjeve potenciale për eksport. Qëllimi përfundimtarë i sektorit është rritja e eksportit, përmirësimi i bilancit tregtar të Kosovës me vendet e tjera tërheqja e turistëve të jashtëm dhe promovimi i potencialeve eksportuese dhe të turizmit.

Me qëllim të arritjes së objektivave:

- Bashkëpunojmë me kompanitë prodhuese eksportuese, asociacionet e bizneseve, institucionet donatore, operatorët turistikë për bashkërenditje të aktiviteteve që ndërlidhen me aktivitetet e sektorit për promovim të eksportit;
- Ndihmojmë kompanitë eksportuese të plasojnë mallrat e tyre në tregjet ndërkombëtare;
- Koordinojmë punët ndërinstitucionale lidhur me çështjet e promovimit të kompanive eksportuese dhe operatorëve turistikë;
- Mbështesim organizimin e panairove brenda dhe jashtë vendit;
- Organizojmë seminare dhe takime studimore për plotësim të kërkesave të tregjeve të jashtme;

Promovimi i produkteve vendore

Me qëllim të promovimit të produkteve vendore dhe promovim të potencialeve turistike janë organizuar evenimente të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, me ç'rast janë përzgjedhur kompani/operator të turizmit për pjesëmarrje në panairove ndërkombëtare bazuar në kritere të përcaktuara :

- ✓ Kapacitetet prodhuese të kompanive vendore për pjesëmarrje në panairove.
- ✓ Plotësimin e kriterëve minimale lidhur me certifikim të kompanive.
- ✓ Orientimin e kompanive se në cilat tregje mund ti plasojnë produktet-shërbimet për të krijuar marrëveshje kontraktuale.
- ✓ Profilin e panairit (shitës për konsumator ose kontraktues).
- ✓ Sukseset dhe eksperiencat e fituar nga pjesëmarrja në panairove të ndryshme

Pjesëmarrja në panairot ndërkombëtare

Gjatë vitit 2018 organizuar nëntë (9) panairove ndërkombëtare ku kanë marrur pjesë 36 kompanive në ekspozimin e produkteve në këto panairove.

Panairot e organizuar janë:

- ✓ **Turizëm, janë organizuar katër (4) panairove:**
 - ITB në Berlin,
 - Destination Nature në Paris,
 - Fiera della Grazie në Itali dhe panairin
 - Tourism Expo në Japoni.

- ✓ **Industri Ushqimore, janë organizuar katër (4) panaire:**
 - Pro Wein në Gjermani,
 - PLMA në Holandë,
 - SIAL Paris dhe
 - PLMA Chicago.

- ✓ **Industria e drurit, është organizuar dy (2) panaire dhe një (1) mision shitës:**
 - Panairi MOW në Gjermani,
 - Swiss Bau në Zvicërr,
 - Organizimi i misionit shitës për sektorin e drurit, i cili mision është realizuar në bashkëpunim me projektin e komisionit evropian EDP dhe GIZ dhe kanë marrur pjesë 10 kompani nga sektori i drurit.

Organizimi i konferencave sektoriale

Me qëllim të ngritjes së konkurrueshmërisë dhe eliminimit të sfidave në kompanitë eksportuese së bashku me projektin ICEP janë organizuar pesë (5) konferenca sektoriale:

- ✓ Sektori i drurit
- ✓ Sektori i tekstilit dhe lëkur përpunimit
- ✓ Sektori metaloperpunuese,
- ✓ Sektori i ndërtimtarisë
- ✓ Sektori i turizmit

2. Drejtoratit për Zhvillim të Sektorit Privat

Drejtorati për Zhvillim të Sektorit Privat ka për qëllim të zhvilloi dhe mbikëqyrë zbatimin e politikave dhe procedurave standarde dhe ofrimi i me qëllim të rritjes së qëndrueshme dhe vazhdueshme të ndërmarrësisë dhe zonave ekonomike. Në kuadër të së cilit bëjnë pjesë dy sektorë:

1.1 Sektori për zhvillimin e ndërmarrje të vogla dhe të mesme

1.2 Sektorit për zhvillimin e zonave ekonomike

2.1. Sektori për NVM-ve

Sektori për ndërmarrje te vogla dhe të mesme ka për qëllim të zbatoi politikat dhe procedurat standarde dhe të ofroj shërbime për zhvillimin e ndërmarrësisë.

Me qëllim të zhvillimit të ndërmarrësisë janë realizuar këto aktivitete:

A. Anëtarësimi në programet ndërkombëtare

- Akti Evropian për Biznes të Vogël (ABV), Kosova si anëtare e ABV-së ka arritur që vitit 2018 në bazë të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.02/129 për Koordinimin e Aktit të Biznesit të Vogël (ABV) për Evropë, të formoj 12 grupe punuese për plotësimin e 12 dimensioneve të dalura nga ABV-ja. Njëherit në Prishtinë është mbajtur takimin dakordues për vlerësimin e Aktit për Biznes të Vogël për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë (2016-19) ndërmjet përfaqësuesve të OECD-së dhe Kosovës, ku janë diskutuar të gjitha dimensionet dhe janë ofruar informata shtesë nga ana e përfaqësuesve të Kosovës. Raporti aktualisht qëndron në fazen përpiluese nga ana e perfaqësuesve te OECD dhe do të publikohet në vitin 2019.
- Konkurrueshmëria në Evropën Juglindore Outlook-u i Politikës 2018, Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë në bashkëpunim me përfaqësuesit e OECD-së dhe në mbështetje të Komisionit Evropian ka arritur që të kompletoj të dhënat e kërkuara në 17 kapitujt e këtij dokumenti dhe me 11 shtator 2018 ka organizuan konferencën në Prishtinë me temë “Konkurrueshmëria në Evropën Juglindore, Pikëpamja për Politikën 2018”, ku është bërë lansimi i raportit. https://read.oecd-ilibrary.org/development/competitiveness-in-south-east-europe_9789264298576-en#page1
- Fondi i Ballkanit Perëndimor për zhvillim të ndërmarrësisë dhe inovacionit (ËBEDIF), Kosova si nënshkruese e marrëveshjes, përmes këtij programi synon të krijojë një mjedis më të favorshëm për financim të NVM-ve dhe një treg të qëndrueshëm të kapitalit afatgjatë. Kjo përfshinë promovimin e reformave të politikave për të krijuar kuadrin e nevojshëm politik që mbështet financimin e NVM-ve. Në kuadër të këtij programi, Kosova për vitin 2018 ka përmbushur obligimet financiare.

- Programi COSME, në kuadër të aktiviteteve të saja ka edhe programin COSME, e cila është finalizuar suksesshëm me nënshkrimi i marrëveshjes për anëtarësimin e Kosovës në Programin COSME dhe janë ekzekutuar obligimet financiare. Njëherit është realizuar konferenca lidhur me njoftimin e NVM-ve për mundësitë që ofron ky program. Programi ka për qëllim zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe ka një mandat trevjeçar.

B. Financimi i NVM-ve

- Subvencionim për NVM

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve prodhuese si dhe rritja e aftësisë konkurruese të ndërmarrjeve tona në tregun vendor dhe të jashtëm, janë mbështetur financiarisht 35 ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme për blerjen të makinerisë së re prodhuese. Për realizimin e këtyre projekteve nga ana e bizneseve janë deklaruar që do të investohen mbi 1,7 milion euro dhe të punësohen mbi 500 persona.

Kompanitë përfituese sipas kategorizimit të ndërmarrjeve janë:

- ✓ Mikro – 18 ndërmarrje
- ✓ Te vogla – 13 ndërmarrje
- ✓ Te mesme – 4 ndërmarrje

- Skema voucher e certifikimit të produktit

Qëllimi i projektit është standardizimi i produkteve vendore konform direktivave të BE. Lidhur me këtë janë përkrahur katër (4) ndërmarrje që kanë plotësuar kriteret me të cilën është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit për certifikim të produkteve.

C. Informimi i bizneseve

- Ditët e Biznesit të Vogël

Në kuadër të “Ditëve të Biznesit të Vogël 2018”, me qëllim të fuqizimit dialogut publiko-privat për zhvillimin e ekonomisë kosovare si dhe informimit të bizneseve për projektet përkrahëse janë realizuar shtatë konferenca me bizneset. Konferencat janë realizuar në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, Aleancën Kosovare të Bizneseve (AKB) dhe Klubin e Prodhueseve të Kosovës. Organizimi i këtyre konferencave ka qenë njoftimi i bizneseve me planet e Qeverisë dhe promovimi i ekonominë vendore, të rrit konsumimit të prodhimeve vendore, etj.

“Top NMVM-të më konkurrenente”, me qëllim të organizimit të garës vjetore për NVM-të më konkurrenente në 7 rajonet e Kosovës, në kuadër të Ditëve të Biznesit të Vogël, në bashkëpunim me Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (TRUST), Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) dhe Dogana e Kosovës, kemi përzgjedhur 21 ndërmarrjet me të suksesshme.

D. Organizimi i panairove vendore

- Panairi Gratë në Biznes 2018, ka për qëllim promovimin e ndërmarrësisë së bizneseve me pronare të gjinisë femërore. Lidhur me këtë është realizuar panairi tregëtorë në Prishtinë ku kanë marrur pjesë 30 ndërmarrje dhe OJQ.
- Panairi i Gjilanit 2018” ka për qëllim promovimin e ndërmarrësisë së bizneseve mbarëkombëtare, ku kanë marru pjesë mbi 100 biznese nga Kosova, Shqipëria dhe Mali i zi. Panairi është mbajtur në Gjilan.

2.2. Sektori për zhvillimin e Zonave Ekonomike

Krijimi i zonave ekonomike ka për qëllim nxitjen dhe inkurajimin e investimeve, nxitjen e investimeve private në veprimtaritë prodhuese, hapjen e vendeve të reja të punës, përqendrimin e bizneseve në një vend të caktuar dhe promovimin e tyre; zgjerimin e bashkëpunimit mes bizneseve; krijimin e kushteve për biznese për qasje më të lehtë në transport. Po ashtu, ndihmon në rritjen e konkurrencës në biznesin vendor dhe ndërkombëtar, tërheqjen e teknologjive të përparuara dhe rritjen e konkurueshmërisë së prodhimeve dhe shërbimeve vendore.

Me vendime/pëlqim të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë janë shpallur nëntë (9) zona ekonomike:

1. Parku i Biznesit në Drenas,
2. Parku i Biznesit në Mitrovicë,
3. Parku Teknologjik- Shtime,
4. Parku Industrial në "Frashër i vogël-Zhigovina" në Mitrovicë,
5. Zona Agro - Industriale në Suharekë,
6. Parku industrial në Lipjanit,
7. Parku industrial në Viti,
8. Parku Industrial në Suharekë dhe
9. Parku Industrial në Vushtrri.

Përkrahja financiare për ndërtimin e zonave ekonomike

Në fillim të vitit 2018, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë respektivisht Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), ka nënshkruar Marrëveshje bashkëfinancimi me komunat e Suharekës, Vitisë dhe komunën e Vushtrrisë. Gjendja është si në vijim:

- ✓ Zona ekonomike / Parku Industriale në Budrikë - Viti, më datë 19.03.2018 është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit MTI-KK Viti për projektin “Parku Industrial në Budrikë” për vitet 2018-2020. Njëherit Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka zhvilluar të gjitha procedurat për kontraktimin e operatorit ekonomik për ndërtimin e infrastrukturës fizike në Parkun Industrial në Budrikë-Viti dhe kanë filluar punimet. Kontrata është me afat trevjeçar, e cila parasheh finalizimin e infrastrukturës fizike.
- ✓ Zona ekonomike / Parku Industrial në Shirokë - Suharekë, me datë 27.04.2018 është nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit MTI-KK Suharekë për projektin “Parku Industrial në Shirokë” për vitet 2018-2020. Njëherit Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka zhvilluar të gjitha procedurat për kontraktimin e operatorit ekonomik për ndërtimin e infrastrukturës fizike në Parku Industrial në Shirokë dhe kanë filluar punimet. Kontrata është me afat trevjeçar, e cila parasheh finalizimin e infrastrukturës fizike.
- ✓ Zona Ekonomike / Parku Industrial në Lumadh- Vushtrri, me vendim të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë të datës 25.04.2018, është themeluar “Parku Industrial në

Lumadh”- Vushtrri. Ndërsa me datë 16.07.2018 është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit MTI- KK Vushtrri për projektin “Parku Industrial në Lumadh” për vitet 2018/2020. Njëherit Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka zhvilluar të gjitha procedurat për kontraktimin e operatorit ekonomik për ndërtimin e infrastrukturës fizike në Parku Industrial në Lumadh.

- ✓ Zona Ekonomike në Malishevë - me vendim të Qeverisë së Kosovës me datë 05.06.2018 është nxjerr vendimi për shpalljen me interes të veçantë ekonomike me qëllim të themelimit të zonës ekonomike. Me datë 22.06.2018 MTI dhe komuna e Malishevës kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për projektin e zonës ekonomike në Malishevë, njëherit është përgatitur elaborati i shpronësimit dhe është përcjell në MMPH, po ashtu MTI ka hartuar Studimin e fizibilitetit për zonën ekonomike.
- ✓ Inkubatori i biznesit në Malishevë, është shqyrtuar dokumentacioni i pranuar nga komuna e Malishevës për themelimin e inkubatorit të biznesit, me çrast Komuna është pajisur me pëlqim për themelimin e inkubatorit të biznesit. Njëherit është nënshkruar marrëveshja MTI -KK Malishevë për financimin e Inkubatorit të biznesit. MTI ka zhvilluar procedurat e prokurimit për kontraktimin e operatorit ekonomik për ndërtimin e objektit të inkubatorit të biznesit në komunën e Malishevës.
- ✓ Parku i Biznesit në Drenas (PBD), në kuadër të PBD-së janë realizuar aktivitetet me qëllim të mbarvajtjes së sa më të mirë të parkut dhe funksionimit të ndërmarjeve që janë të vendosura brenda këtij parku.